

RAPORTI KRYETARIT 2016 -
Faik Mahmuti

Të nderuar anëtar/e të shoqatës, të nderuar të pranishëm Para një viti në kuvendin e kaluar të shoqatës mora besimin tuaj për ta udhëhequr shoqatën 17shkurti.ch si kryetar i saj. Falenderoj gjithë anëtarët e shoqatës, të cilet paguan anëtarësinë për vitin 2016, në këtë vit kanë paguar mbi 153 anëtar të rregullt plus anëtarët lokal. Fatëkeqësisht për këtë vit nuk kemi gjetur sponsor gjeneral.

Një falenderim i veçant është për sponsorët e shoqatës pothuaj të rregullt:

- Arsat GmbH - DIGITALB.CH
- Klubin Iliria
- Goni Coiffeur Ismaili & Co
- Maliqi Automobile GmbH
- Allenmoos Garage
- Dr. Sefer Gashi
- Mode Boutique USA

Gjithëashtu i falenderoj edhe sponsorët lokal për përkrahjen e tyre, ku pa ndihmën e tyre nuk do të kishim mundësi të realizonim gjithë këto projekte.

Shoqata 17shkurti.ch edhe këtë vitë realizoi shumë projekte:

- Shporta të mbeturinave
- Shpërblimi i nxënësëve
- Blerja e shiritave për nxënës TCS
- Mirëmbajtja e fshatit
- Mirëmbajtja e lumit dhe varrezave
- Blerja e një makine për bari
- Blerja e drimër kositëse
- Blerja e disa mjetëve të vogla për mirëmbajtje
- Blerja e materialit hargjuesë dhe reparimeve të makinave për mirëmbajtje
- Mbledhja e disa qepëve të lulëve për pranverë
- Blerja e një Laptop-i për administratën e shoqatës
- Java kuturore – Turniri i futbollit
- Organizimi – Iftarë publik
- Organizimi për muezin
- Ndihma familjeve skamnore
- Mbledhja e drujëve dekorativ
- Mbledhja e lulëve në fshat
- Përfundimi i Camp-shtëpizës dhe përrurimi i saj
- Aksioni i xhamisë së epërme
- Përrurimi i shtëpisë për fam. T. Subovci

Një ndër projektet më të kushtueshme mbetet mirëmbajtja e fshatit, por ky projekt është aq i rëndësishëm, sa që na bën të gjithë krenarë që jemi nga fshati Dobërçan. Lirisht mund të themi se jemi fshati më i pastër në Kosovë dhe Rajon. Gjatë vitit 2016 nuk kena mbajtur shumë mbledhje të kryesisë. Fatkeqësisht nuk kemi mundur të mbami protokoll në çdo mbledhje si dhe nuk kemi publikuar protokollet në webfaqen tonë. Shpresoj që në të ardhmën të publikojmë protokollet e çdo mbledhje të kryesisë.

Shpresoj që shoqata edhe në të ardhmën të vazhdoj me projekte si deri më tani dhe ta shton numrin e anëtarësisë

Me respekt

Faik Mahmuti

